

20080841563

## L I G J

### **PËR HYRJE NË BORXH TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË TE BANKA PËR ZHVILLIM PRANË KËSHILLIT TË EVROPËS SIPAS MARRËVESHJES KORNIZË PËR HUA PËR FINANCIMIN E PJESSHËM TË "PROJEKTIT PËR NDËRTIMIN E SALLAVE TË FIZKULTURËS"**

#### Neni 1

Republika e Maqedonisë hyn në borxh te Banka për Zhvillim pranë Këshillit të Evropës me hua në shumë prej 12.500.000 euro, për financimin e pjesshëm të "Projektit për ndërtimin e sallave të fizkulturës".

#### Neni 2

Kushtet dhe mënyra e shfrytëzimit të mjeteve nga huaja e nenit 1 të këtij ligji, do të përcaktohen me Marrëveshjen Kornizë për hua për financimin e pjesshëm të "Projektit për ndërtimin e sallave të fizkulturës", e cili do të lidhet ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Bankës për Zhvillim pranë Këshillit të Evropës.

Kushtet e shfrytëzimit të mjeteve për secilën transhë veç e veç do të përcaktohen me Marrëveshjet plotësuese për hua, të cilat janë pjesë përbërëse të Marrëveshjes Kornizë për hua për financimin e pjesshëm të "Projektit për ndërtimin e sallave të fizkulturës".

Në emër të Republikës së Maqedonisë, Marrëveshja Kornizë për hua nga paragrafi 1 i këtij neni do ta nënshkruajë ministri i Financave.

#### Neni 3

Afati i pagesës së huas nga neni 1 i këtij ligji është 15 vjet, me grejs periudhë të kyçur prej 5 vitesh.

Huaja do të tërhiqet së paku në dy transhe.

Transha e parë duhet të tërhiqet në afat prej 12 muajsh nga hyrja në fuqi e Marrëveshjes Kornizë për hua nga neni 2 paragrafi 1 i këtij ligji dhe nuk duhet të tejkalojë 50% të shumës së përgjithshme të huas.

Tërheqja e secilës transhë të ardhshëm do të realizohet pasi që Republika e Maqedonisë me shkrim do ta njoftojë Bankën për Zhvillim pranë Këshillit të Evropës që 90% e shumës së transhës paraprake është alokuar.

#### Neni 4

Shkalla e interesit do të caktohet për secilën transhë të huas veç e veç, në ditën e tërheqjes së mjeteve të huas, varësisht nga ajo se cila shkallë e interesit është më e volitshme për Republikën e Maqedonisë (fikse ose variable).

#### Neni 5

"Projekti për ndërtimin e sallave të fizkulturës" nga Marrëveshja Kornizë për hua nga neni 2 paragrafi 1 do ta realizojë Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

#### Neni 6

Republika e Maqedonisë huan do ta paguajë nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.

#### Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi me ditën e botimit në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë".